

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I SHOQERISE "VALËZA" SH.P.K

THEMELUES/IT:

Muhamet Sejdiu, atësia Ahmet, shtetas Kosovar, lindur në Siboc me adresë Kosove, lindur më 06/12/1966, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga pasaporta kosovare me numer 1030409236.

i cili, bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare » i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", LIGJ Nr. 131/2015 PËR QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil si dhe ne vullnetin e lire te shprehur rane dakort dhe nenshkruan aktet e themelimit te shoqerise me termat ne vijim:

KREU 1

THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI. 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

1. Sot ne date 29.07.2021, u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin "VALËZA" SH.P.K
2. Themelues i shoqerise eshte:
 - **Muhamet Sejdiu**, atësia Ahmet, shtetas Kosovar, lindur në Siboc me adresë Kosove, lindur më 06/12/1966, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga pasaporta kosovare me numer 1030409236

NENI. 2

OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kesaj shoqerie do te jete:

1. Aktivitet ne fushen e ndertimit , punime te ndryshme te ndertimit. Veprimtari investuese ndertimore per objekte civile, industriale, banesa e te tjera, per persona fizik e juridik, vendas dhe te huaj,punime te specializuara ndertime etj. Punime te çdo lloji ne fushen e ndertimit .
2. Shoqeria ka per objekt gjithashtu edhe kryerjen e aktiviteteve tregtare ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi. Ne menyre me specifike, objekti i aktivitetit te shoqerise do te jete edhe agroturizmi, ofrimi i sherbimeve akomoduese, perpunimin e produkteve bujqesore, blegtorale, te cilat jane te pershtatshme per zhvillimin e veprimtarive te agroturizmit.
3. Manaxhim i fermave blegtorale, etj. Sherbim ushqimi, restorant, import-eksport, veprimtari ne fushen e hoteleri –turizmit.

Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI. 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te pacaktuar.



NENI. 4
SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise eshte ne adresen: *Karpen, Kavaje, Pasurie me nr. 1/20, me kod unik 2099009074, ZK 2099, pasuri e ndodhur ne Karpen, Kavaje*

KREU II
KAPITALI
NENI. 5

KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 100 (njeqinde) leke i perbere nga nje kuote qe zoterohet teresisht nga ortaku themelues.

- **Muhamet Sejdiu**, atësia Ahmet, shtetas Kosovar, lindur në Siboc me adresë Kosove, lindur më 06/12/1966, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga pasaporta kosovare me numer 1030409236.

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta).

NENI. 6
ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

NENI. 7
TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III
ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI. 8
ORGANET VENDIMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a) Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b) Ndryshimet e statutit
- c) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve



- d) Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e) percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f) Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g) Miratimi i bilanceve
- h) Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j) Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve
- k) Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l) Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9

THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortakët jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

NENI 10

KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi te permendur ne paragrafin e mesiperem nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mbledhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit, zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane **QKB** per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin per:



- a) vleresimin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqsohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13 ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emerom nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 3 vjet me te drejte ripertitje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte ndaj pas regjistrimit ne QKB.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise:

- Muhamet Sejdiu, atësia Ahmet, shtetas Kosovar, lindur në Siboc me adresë Kosove, lindur më 06/12/1966, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga pasaporta kosovare me numer 1030409236.

NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine.
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportoje para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimatrine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

NENI 15 PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprime ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.
2. Nese administratori vepron ne kundershtrim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.



KREU IV
VITI FINANCIAR –EKSPERTET

NENI 16
VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 dhjetor.

NENI 17
EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara.

KREU V
PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 18
PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise.
- b) Me vendimet e asamblese se Ortakeve.
- c) Me hapjen e procedurave te falimentit.
- d) Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare et Regjistrimit,
- e) Me vendim gjykate.

NENI 19
RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shoqerite tregtare.

NENI. 20
LEGJISLACIONI

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 22
MOSMARRVESHJET

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte ligjore.

ORTAKU THEMELUES

Muhamet Sejdiu

Muhamet Sejdiu. Sejdiu